

20240741574

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

### L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN SHËNDETËSORE

#### Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16 dhe 20/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19, 153/19, 180/19, 275/19, 77/21, 122/21, 178/21, 150/22, 236/22, 199/23, 263/23 dhe 30/24), në nenin 96 në paragrafin (7) fjalët: "paragrafi (5)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (6)".

Në paragrafin (8) fjalët: "paragrafët (3), (4) dhe (5)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafët (4), (5) dhe (6)".

Pas paragrafit (8) shtohen tre paragrafë të rinj (9), (10) dhe (11), si vijojnë:

"(9) Personat juridikë që kanë për obligim organizimin e qendrave shëndetësore nga paragrafët (4), (5) dhe (6) të këtij neni kanë për detyrë që të sigurojnë persona të cilët ofrojnë ndihmë mjekësore personave të cilët janë në gjendje të rrezikshme për jetën, të përfundojnë trajnim sipas programit për mbajtjen themelore në jetë duke përdorur defibrilator të jashtëm automatik që e zbaton Qendra Mjekësore e Simulimit.

(10) Pas përfundimit me sukses të trajnimit nga paragrafi (9) i këtij neni, Qendra Mjekësore e Simulimit lëshon certifikatë.

(11) Programin nga paragrafi (9) i këtij neni e miraton Qendra Mjekësore e Simulimit, për të cilin pëlqim jep ministri i Shëndetësisë."

Paragrafi (9) bëhet paragraf (12).

#### Neni 2

Neni 204-a ndryshohet si vijon:

"(1) Me përjashtim nga neni 204 alineja 6 të këtij ligji, për shkak të kryerjes së pandërprerë të veprimtarisë shëndetësore në rrjetin e institucioneve shëndetësore, punëtori shëndetësor, përkatësisht bashkëpunëtori shëndetësor, nga drejtori i institucionit shëndetësor në të cilin është i punësuar mund të kërkojë t'i vazhdohet kontrata e punësimit më së shumti deri në moshën 67 vjeç.

(2) Deklaratën me shkrim, punëtori shëndetësor përkatësisht bashkëpunëtori shëndetësor e jep më së voni deri më 31 gusht të vitit rrjedhës për vazhdimin e kontratës së punësimit nga paragrafi (1) i këtij neni, ndërsa për çdo vazhdim të mëtejshëm të kontratës së punësimit deklaratën e jep një herë në vit, më së voni deri më 31 gusht të vitit rrjedhës për vazhdimin e kontratës së punësimit për vitin e ardhshëm.

(3) Drejtori ka për detyrë pas deklaratës së dhënë ta vazhdojë kontratën e punësimit më së shumti deri më 67 vjeç. Vendimin për vazhdim e miraton më së voni deri më 31 gusht të vitit që i paraprin vitit në të cilin punëtori shëndetësor, përkatësisht bashkëpunëtori shëndetësor i plotëson kushtet nga neni 204 alineja 6 të këtij ligji. Për çdo vazhdim të mëtejshëm të kontratës së punësimit nga paragrafi (2) i këtij neni, drejtori e miraton vendimin një herë në vit, më së voni deri më 31 gusht të vitit që i paraprin vitit për të cilin vazhdohet kontrata e punësimit.

(4) Për vazhdimin e kontratës së punësimit të punëtorit shëndetësor, përkatësisht bashkëpunëtorit shëndetësor, në përputhje me kushtet e këtij neni, drejtori i institucionit shëndetësor e njofton Ministrinë e Shëndetësisë dhe Fondin."

Neni 3

Në nenin 312 në paragrafin (11) fjalët: "paragrafët (3), (4) dhe (5)" dhe zëvendësohen me fjalët: "paragrafët (4), (5), (6) dhe (9)".

Neni 4

Dispozitat nga neni 1 me të cilin në nenin 96 shtohen paragrafë të rinj (9), (10) dhe (11) do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2026.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".